



Teksti zyrtar siç është amendamentuar me 11.11.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të nenit 44 dhe 64.2, pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe nenit 17 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 13/2009

FUSHATA E ZGJEDHJEVE DHE NJOFTIMI PËR NGJARJET POLITIKE

Neni 1

Përkufizimet

1.1 Me “periudhë të fushatës së zgjedhjeve” nënkuptohet periudha që fillon tridhjetë (30) ditë para Ditës së Zgjedhjeve dhe përfundon një ditë para Ditës së Zgjedhjeve, gjatë të cilës subjekteve politike të certifikuara u lejonet që aktivisht t’i promovojnë platformat e tyre politike, idetë dhe parimet me qëllim që t’i fitojnë votat e elektoratit në favor të kandidatëve të tyre. Kohëzgjatja e fushatës për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave do të caktohet me vendim të veçantë të KQZ-së.

1.2 Me “tubim politik” nënkuptohet tubimi publik që mbahet në hapësira të mbyllura ose të hapura, grumbullimi, diskutimi, marshimi ose debati publik i ideuar me qëllim të përhapjes së porosisë politike për të fituar përkrahjen e votuesve dhe që zhvillohet në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi.

1.3 “Subjekti politik” (SP) do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

1.4 Me “përfaqësues” të subjektit politik (SP) nënkuptohen anëtarët dhe kandidatët e subjektit politik dhe personat e ngarkuar nga subjekti politik për të ndihmuar në përgatitjen dhe zhvillimin e fushatës së zgjedhjeve.

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

2.1 Gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve, subjektet politike të certifikuara kanë të drejtë të:

- (a) organizojnë dhe mbajnë tubime publike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, intervista, fjalime ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t’i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre;
- (b) publikojnë dhe shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore; dhe

- (c) të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv, të radios apo kabllor, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, rrjetit telefonik, sistemit postar ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues.
- (d) Subjektet e certifikuar politike aktivitet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë në pajtueshmeri me rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) Kodin e Mirësjelljes të nxjerrur nga Komisioni i Pavarur i Mediave dhe të ndonjë legjisllacioni tjetër në fuqi.

2.2 Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë e të punësuarve në; Institucionet shtetërore dhe publike , Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës dhe personeli i tyre, organizatat bamirëse dhe fetare, përfaqësuesit e bashkësive fetare, KQZ-ja, Sekretariati i KQZ-së dhe Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe përfaqësuesit e organizatave të mjeteve të informimit masiv, kur ata janë të angazhuar në aktivitetet e tyre profesionale si dhe personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në Ditën e Zgjedhjeve.

Neni 3

Materialet e shtypura të fushatës së zgjedhjeve

3.1 Të gjitha materialet e shtypura, ato audiovizuale dhe materialet e tjera të zgjedhjeve duhet ta mbajnë emrin e subjektit politik të certifikuar që e ka porositur përgatitjen e materialit të tillë.

3.2 Materiali i zgjedhjeve nuk duhet të përmbajë reklama komerciale.

3.3 Autoritetet komunale duhet t'i caktojnë vendet e posaçme për ekspozimin e materialit të shtypur të zgjedhjeve dhe të materialit të informimit publik të përgatitur nga KQZ-ja. Vendet e tilla duhet të caktohen në hapësirat më të frekuentuara dhe më të dukshme në atë komunë.

3.4 Materialet e zgjedhjeve nuk duhet të vendosen brenda hapësirës së institucioneve publike, shkollave, objekteve fetare, ose objekteve në pronësi shtetërore, në monumente, ndërtesa, struktura dhe objekte të cilat kanë vlerë historike, kulturore, fetare ose arkitekturore, brenda ndërtesave dhe zyrave të KQZ-së dhe brenda qendrave të votimit ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metrash nga hyrja e tyre.

3.5 Materialet e shtypura të zgjedhjeve mund të ekspozohen edhe brenda objekteve në pronësi private, ndërtesave, strukturave, ose objekteve të tjera, përveç atyre të saktësuara në nenin 3.4, pas miratimit paraprak të pronarëve të tyre.

3.6 Cilido subjekt politik i certifikuar duhet të ekspozojë materialin e vet të zgjedhjeve në atë mënyrë që të mos e pengojë pamjen e materialeve të zgjedhjeve që u përkasin subjekteve të tjera politike të certifikuar.

3.7 KKZ-të duhet që aktivisht ta monitorojnë shfrytëzimin e materialeve të shtypura, atyre audiovizuale dhe të çfarëdo materialeve të tjera të zgjedhjeve të subjekteve politike të certifikuar gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve. Në rast të shkeljes së Kodit të Sjelljes për zgjedhjet ose të dispozitave të përcaktuara me Rregullat e Zgjedhjeve të KQZ-së ose ligjit në fuqi, KKZ-të duhet që menjëherë ta informojnë subjektin politik në fjalë që të marrë masa korrigjuese. Nëse shkeljet përsëriten nga i njëjti subjekt politik ose i njëjti refuzon që t'i korrigjojë shkeljet e identifikuar, ZKZ-ja duhet ta raportojë rastin në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Neni 4

Organizimi dhe mbajtja e tubimeve publike

4.1 Subjektet politike të certifikuara nuk duhet t'i mbajnë tubimet publike brenda hapësirës së ndërtesave që shfrytëzohen nga Qeveria, Institucionet dhe Agjensitë e Pavarura të Republikës së Kosovës ashtu siç përcaktohen në Kreun XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në shkolla gjatë orëve të mësimi, spitale, objekte të FSK-së, objektet e kultit, objekte fetare, ose vende në pronësi private pa pëlqimin e pronarëve të tyre. Shkollat nuk duhen të përdorën për tubime publike përveq nëse Qeveria e Kosovës vendos ndryshe që ato të përdorën vetëm pas orarit të punës.

4.2 Subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim politik duhet që të Zyratari Komunal i Zgjedhjeve i asaj komune (ZKZ) ta dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNjMTP), si në Shtojcën 1, së paku shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara.

4.3 ZKZ-ja, njëzet e katër orë (24) pas marrjes së një FNjMTP-je nga një subjekt politik duhet që:

(a) t'ia përcjellë FNjMTP-në stacionit më të afërt policor në zonën ku do të mbahet tubimi publik dhe do ta informojë në mënyrë të duhur subjektin politik të certifikuar, në rast se nuk janë dorëzuar FNjMTP të ngjashme nga subjektet e tjera politike për mbajtjen e një tubimi publik në vendin dhe kohën e njëjtë ose në kohën dhe vendin e përafërt gjegjës; ose

(b) të vendosë se cili subjekt politik do ta mbajë tubimin publik, e cili jo, në rast se është dorëzuar një FNjMTP tjetër nga një subjekt tjetër politik për mbajtjen e një tubimi publik në vendin dhe kohën e njëjtë ose për kohën dhe vendin e përafërt gjegjës. ZKZ-ja duhet t'i informojë subjektet politike të certifikuara në mënyrë të duhur.

(c) Nëse dy apo më shumë subjekte politike propozojnë të mbajnë tubime, ngjarje publike në të njëjtën kohë në vend, atëherë subjekti që ka aplikuar i pari ka do të ketë përparësi. Megjithatë asnjë subjekt politik nuk do të lejohet haspira publike

4.4 Subjekti politik i certifikuar që ka marrë përgjigje negative nga një ZKZ në kërkesën për mbajtjen e tubimit publik si në 4.3(b) të kësaj Rregulle, mund të ushtrojë ankesë ndaj atij vendimi në KQZ, brenda dyzet e tetë (48) orësh nga koha e marrjes së njoftimit të tillë. Vendimi i KQZ-së do të jetë përfundimtar.

4.5 Subjekti politik i certifikuar do ta mbajë tubimin publik duke i respektuar të gjitha parimet ligjore me të cilat rregullohen tubimet publike.

4.6 ZKZ-ja duhet të mbajë shënime për të gjitha FNjMTP-të e marra dhe kopjet e letërkëmbimit me shkrim me subjektet politike dhe policinë, për çdo referim në të ardhmen.

4.7 ZKZ-ja është përgjegjës të mbajë koordinim të vazhdueshëm me policinë dhe të informohet për çdo shkelje të Kodit të Sjelljes për subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre që mund të ndodhin gjatë tubimeve publike. Raportet e policisë në lidhje me prishjen e ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion KQZ-së dhe PZAP-it. Çdo shkelje serioze duhet që menjëherë të raportohet në PZAP për veprim të mëtejshëm nga ana e tyre.

4.8 Mosmarrëveshjet në lidhje me mbajtjen e ndonjë ngjarje politike në vendet publike mund të shqyrtohen dhe zgjidhen nga PZAP-i.

Neni 5

Pjesëtarët e armatosur të njësisë për mbrojtje nga afërsia në tubimet publike

Anëtarët e njësisë për mbrojtje nga afërsia, të autorizuar nga autoriteti i ligjit në fuqi për bartjen e armëve, të cilët janë në detyrë, identifikohen paraprakisht në çdo tubim dhe pas kërkesës së zyrtarit të pranishëm të Policisë së Kosovës. Të gjitha armët që mbahen duhet të mbahen të fshehura.

Neni 6

Tubimet e paautorizuara publike

6.1 Çdo tubim publik i mbajtur pa e dorëzuar FNjMTP-në ose pas refuzimit të FNjMTP-së nga ZKZ-ja ose policia, është i paautorizuar dhe do të konsiderohet shkelje e kësaj Rregulle.

6.2 Nëse ZKZ-ja ose zyrtarët e Policisë së Kosovës hasin në tubim publik të paautorizuar, ata duhet ta informojnë PZAP-in për hollësitë e tubimit publik: për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve në atë tubim publik, për subjektin politik që e mban tubimin publik, si dhe çdo informatë tjetër relevante lidhur me atë tubim publik.

Neni 7

Veprimet e ndaluara para dhe gjatë Ditës së Zgjedhjeve

7.1 Gjatë periudhës 24 orëshe para hapjes së vendotimeve për zhvillimin e votimeve, e deri në mbyllje të tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohet kryerja e çfarëdolloj aktiviteti që lidhet me fushatën e zgjedhjeve, siç janë:

- a) mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës së zgjedhjeve;
- b) shpërndarja ose ekspozimi i çfarëdolloj materiali në cilëndo qendër të votimit, ose brenda hapësirës prej njëqind (100) metrash përreth, me qëllim të ndikimit në votues ose të kërkimit të mbështetjes nga personat që hyjnë në qendrat e votimit për të votuar;
- c) shfrytëzimi i megafonave ose i sistemeve të tjera për t'iu drejtuar publikut kudo qoftë në Kosovë me qëllim të ndikimit në votues, ose organizimi i çfarëdo manifestimi, procesioni ose demonstrate të natyrës politike ose pjesëmarrja në të;
- d) shitja, furnizimi, blerja, shërbimi ose konsumimi i pijeve alkoolike më afër se njëqind (100) metra nga cilado qendër e votimit në Ditën e Zgjedhjeve;
- e) shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare me qëllim të ndikimit në votues;
- f) zhvillimi i çfarëdolloj fushate të zgjedhjeve në objektet e qendrës së votimit;
- g) mbajtja e kartelave të zgjedhjeve, distinktivëve ose e shenjave të tjera të zgjedhjeve nga anëtarët e këshillit të vendvotimit, vëzhguesit e akredituar ose votuesit në Ditën e Zgjedhjeve që promovojnë një subjekt të caktuar politik.

7.2 Rezultatet e anketave të hulumtimit të opinionit publik ose analizat në lidhje me qëllimet e votimit të zgjedhësve në zgjedhje, nuk duhet të publikohen ose t'i kumtohen publikut gjatë kësaj periudhe, duke filluar pesë (5) ditë para hapjes së vendotimeve dhe duke përfunduar me mbylljen e votimeve.

7.3 Të gjitha SP të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit.. Subjektet politike të cilave i është gjetur ndonjë

material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të kësaj rregulle dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Sanksionet

8.1 Parandalimi ose pengimi i thirrjes ose mbajtjes së një tubimi publik legal është i kundërligjshëm dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit sipas nenit 173 të Kodit Penal të Kosovës. Kur kjo shkelje është kryer nga një person zyrtar duke abuzuar me pozitën e tij apo të saj, kryeresi i vepres penale duhet të dënohet me burgim deri në dy (2) vjet, në përputhje me Nenin 173 të Kodit Penal të Kosovës

8.2 Parandalimi i shtypjes ose i shpërndarjes së materialeve të shtypura, në këtë rast i materialeve të shtypura të fushatës së zgjedhjeve, është i kundërligjshëm dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit sipas nenit 175 të Kodit Penal të Kosovës.

8.3 Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve me anë të përdorimit të dhunës, kanosjes serioze, ryshfetit, ose duke keqpërdorur varësinë ekonomike dhe profesionale të votuesit për të ndikuar që ai/ajo të votojë në një mënyrë të caktuar ose të abstenojë nga zgjedhjet, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tri (3) vjet sipas nenit 177 të Kodit Penal të Kosovës.

8.4 Përveq përgjithësive individuale për shkelje të dispozitave të kësaj rregulle e që dënohen nga Kodi Penal i Kosovës. Cenimi i cilës do procedurë të përcaktuar në këtë Rregull të Zgjedhjeve nga ana e subjektit politik të certifikuar ose përfaqësuesve të tyre do t'i përcillet Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). PZAP-i mund t'i shqiptojë sanksione subjektit politik që ka shkelur këtë Rregull të Zgjedhjeve.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull e ndryshuar zëvendëson Rregullën e mëparshme mbi Fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimin për ngjarjet politike dhe hyn në fuqi më 25.06.2009

Nesrin Lushta

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
